



Republika e Kosovës



Komuna e Istogut

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË PËR FURNIZIM (ME NJË OPERATOR EKONOMIK)

KOMUNA E ISTOGUT, Njesia e Prokurimit te cilën e përfaqëson Menaxheri-ja e Prokurimit z-nja Zizë Bujupaj, Adresa Rruga “Fadil Ferati” nr 121. Me nr. tel 038 200 43 858, ne cilësinë e porositësit te shërbimeve të Autoritetit Kontraktues në njërën anë; dhe

GRUPI I O.E. Haki Bytyqi B.I. & “DDD” Shpk të cilat i përfaqëson z. Haki Bytyqi, nga Istogu, në cilësinë e liderit te Grupit, me Nr. Rexhistrimit të biznesit: 811225251 ne vazhdim “Kryersi i shërbimeve”, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet si më poshtë:

DEZINFEKTIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE

Nr. I prokurimit	633-20 - 5964 -2-2-1/ FA066
Nr. I brendshëm	633 / 020/ 014RR / 221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontrate publike kornizë është të krijoj kushtet, duke përfshirë çmimet dhe rregullat e implementimit për dorëzimin e mallrave si në vijim:

DEZINFEKTIMI I HAPSIRAVE PUBLIKE

Autoriteti Kontraktues bënë Furnizimin vetëm në emër të vetë Autoritetit

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të kryej në bazë të kësaj kontrate publike kornizë,

duhet që të dërgojë “porosinë” tek furnizuesi, duke specifikuar listën me artikuj për furnizim me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative që Autoriteti Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është i detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të kryejnë furnizime të përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi më NËNSHKRIMIN E SAJË PËRKRATËSISHT ME DATË **23.10.2019** DHE DO TE PERFUNDOJË ME SË LARTI DERI ME **23.10.2021** NGA DATA E NËNSHKRIMIT TË KONTRATËS.

1.5 Kjo kontratë mund të shkëputet edhe para skadimit të afatit të paraparë në Nenin 1.4 të kësajë kontrate, po qe se kontrata permbushet me çmimin e paraparë sipas dispozitave të Nenit 56.10 të Udhezuesit Operativ ku thuhet se nese kontrata permbushet me çmim pa marre parasysh Kohën e zgjatjës dhe nënshkrimin original e njëjta shkëputet automatikisht.

Neni 2 Kushtet e dërgesës:

2.1 Afati kohor për dorëzim dhe kryerjen e të gjitha **SHËRBIMEVE** do të jetë: **23.10. 2021** si afat i skadimit të afatit të kontratës.

2.2 Vendi ku do të dorëzohen artikujt do të jenë **INSTITUCIONET KOMUNALE TE ISTOGUT, respektivisht do të caktohet nga Drejtorati për Shërbime Publike.**

2.3. Obligimet e kontraktorit janë të gjitha shërbimet dhe furnizimet të përcaktuara në Nenin 2.1 e dosjes së tenderit dhe kushteve të përgjithshme dhe të veqanta të kontratës.

2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹ (Dërgesat e Detyrës të Paguara).

Neni 3 Origjina:

3.1 Kryersi i shërbimeve duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të tyre. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi:

4.1 Kjo kontratë është e lidhur me çmime për njësi. Çmimet njësi të shërbimeve janë të paraqitura në formularin e çmimeve: **01.06.2020** të kontraktorit pas dhe kjo shumë është është **1.7 €** dhe me shkronja: /Njëpikështatë/

Vlera e parashikuar e kontratës për periudhën deri me **23.10.2021** është: **13.255,00 Euro.** Dhe me shkronja: /Trembëdhjetëmijëedycindpesëdhjetepesëeuro/

Devijimi i lejuar nga totali i kontrates është + - 30 %

Duke qenë se në këtë kontratë, në dispozitat e Nenit 52 pika 6 të Ligjit për Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092 LPP-së dhe Nenin 56 pika 11 të rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik nuk është përcaktuar ndonjë limit financiar ose sasior apo devijim I lejuar nga vlera e parashikuar e kontratës. Menaxheri I Kontratës do ta arsyetojë bindshëm tejkalimin e shpenzimit të vlerës së parashikuar të kontratës në rast se vlera e parashikuar ndryshon në mënyrë substanciale.

4.2 Çmimi i përmendur për NJËSI në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh kontraktorit sipas kontratës publike kornizë.

4.3 Çmimet për njësi janë fikse dhe nuk do t'i nënshtrohen ndryshimeve për porosit e vendosura nën këtë kontratë kornizë.

4.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

Plani për menaxhimin e kontratës

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.




6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye

6.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut:

Për Kontraktuesit:
Haki Bytyçi B.I & DDD Shpk

Emri:	<i>U.D.</i>	Emri:	<i>Haki Bytyçi</i>
Pozita:	<i>Menaxher-it të Prokurimit</i>	Pozita:	<i>L i d e r</i>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	<i>Thohsiu</i>
Data:	<i>23. 10. 2020</i>	Data:	<i>23. 10. 2020</i>
Vula:		Vula:	

PJESA III E KONTRATËS kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Lloji i Kontratës, Kërkesat dhe Kushtet e Dërgesës, Kushtet e Kontratës	5.4	Dërgesat do të kryhet VETËM pas dhënies së "urdhër blerjes" që do të lëshohet nga Autoriteti Kontraktues, gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate publike kornizë. Sherbimet nga O.E. do të ekzekutohen maksimumi 5dite nga dhenia e urdherit për blerje. Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit është: Drejtorati i shërbimeve publike
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 13 muaj.
Kualiteti i Kontrollit	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është :13 muaj
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	<i>Permes Zyres së Prokurimit</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën ekonomike në Pr. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

KOMUNA E ISTOGUT

Dezinfektimi i hapësirave publike		Ngjësia	Sasia	Sasia e përafërtë	Cmimi per Njësia
Specificimi i punëve					
Aktivitetet					
1	Dezinfektimi i objekteve komunale/komuna dhe zyret e vendit. Zjarfiksat, shtëpia e kulturës etj.	m ²	1	24000	0.20
2	Dezinfektimi i objekteve të OKMF-së (OMF dhe Ambulancës)	m ²	1	10500	0.20
3	Dezinfektimi i shtëpisë së pleqëve-Gurakoc	m ²	1	1600	0.10
4	Furnizimi dhe dezinfektimi i objektit të stacionit policor	m ²	1	1200	0.20
5	Dezinfektimi i OKRS-së	m ²	1	1200.00	0.1€
6	Dezinfektimi i objektit të Ambientit	m ²	1	1000.00	0.1€
7	Dezinfektimi i hyrjeve të banesave kolektive	hyrje	1	80.00	0.3€
8	Dezinfektimi i objekteve shkollore	m ²	1	46000.00	0.1€
9	Dezinfektimi i objektit të shpates së të verbereve	m ²	1	500.00	0.1€
10	Dezinfektimi i automjeteve publike	copë	1	450.00	0.1€
11	Dezinfektimi i kamioneve publike	copë	1	160.00	0.1€
12	Dezinfektimi sipas rasteve specifike dhe bazuar në kërkesa të momentit nga organet përkatëse si OKMF, Polici etj.	m ²	1	10.000	0.1€
TOTALI I NJESIVE ME TE GJITHA NGARKESAT					1.7€

Verejtje: shërbimi i Dezinfektimi në përkrahimin e lartshënuar i kryer nga OE duhet të jetë me preparate me substancë me efekt të jetë aktiv kundër Viruseve, bakterieve, majat dhe kepurdhave. Dezinfektimi dhe shpërndarja e preparatit duhet të bëhet me mjete bashkohore si pompa motorike ULV dhe pompa gjera sipas nevojës dhe vendit si dhe me keto udhëzime per përdorim 0.5%(1:200) solucioni është efektiv kundër të gjitha viruseve

